

Universitetet, procesi i kalimit të studimeve nis në fund të muajit

## KRYHET TRANSFERIMI I STU

stri i Mbrojtjes, Imami:  
da 2010-ës, përfundon  
ësimi i municioneve



Faqe 3

Me PD-në, në zgjedhjet  
lore. Luan Rama: Kemi  
ozime dhe për Tiranën

Faqe 3

H, ndërprerje të en-  
isë. Remonte 9-13 gusht.  
ta e zonave dhe qyteteve

Faqe 2

mimi profesional, procedurat  
lëshimin e licensës. Kriteret  
tarifat për regjistrim

Faqe 5

it nga masakra e Dritan  
t. Përkujtohen 4 policët  
ë në krye të detyrës

Faqe 4

### Shëndeti



ëksionet e veshit gjatë  
ës së verës. Si të para-  
ohen dhe të kurohen

e tensioni i ulët vret më  
në se tensioni i lartë.  
oni studimin e fundit

SH jep alarmin: 250 mijë  
ijë në botë humbasin  
imin për shkak të mun-  
ës së vitaminës A

mundjet e barkut,  
aqet dhe rrugët për  
andalimin e tyre

nga Dr. Sali KRASNIQI

Faqe 11-13

*Dokumentacioni për studentët, brenda dhe jashtë vendit.  
dorëzimit, 18 shtator 2010. Cilat janë kriteret e përzgjedhjes?*

## GENOCID KULTUROR. TRADITA MONU E ELBASANIT, DREJT SHKATËR



Qeveria, luftë korrupsioni, rriten investimet e huaja

### FSHZH: Donatorët e huaj, 252 milionë USD në dy vjet

Nuri DRAGOJ



Në vendin tonë ndodhin fenomene interesante. Pozita punon dhe tregon atë çfarë ka bërë, ndërsa opozita kundërshton ato realizime, duke ngritur në qiell "gogolin korrupsion". Dhe donatorët e huaj me të drejtë mund të frenohen apo detyrohen të pyesin...

Faqe 14-15



Berisha thyen rekordin  
e tij të vjetshëm. 127  
minuta not në Dhërmi

Faqe 10

Koalicioni qeveritar i ka shpallur luftë korrupsionit, të majtët ndihen keq për arritjet

# Donatorët e huaj, 252 milionë USD në dy vjet

**FSHZH:** Ju tregojmë miliardat e investimeve në projektet e infrastrukturës. Deri më sot, qeveria shqiptare dhe FSHZH-ja, kanë vënë në zbatim një fond prej 252 milionë dollarësh. Për vitin 2010, janë firmosur marrëveshjet me BERZH-in, BEI, dhe IDB, dhe pritet të fillojë disbursimi i fondeve. Projekti deri në qershor 2010, është financuar nga Banka Botërore (20 milionë USD), OPEC Fund (15 milionë USD), qeveria shqiptare (5 milionë USD), CEB (56 milionë USD ose 40 milionë Euro), programi IPA 2008 (11 milionë USD ose 8 milionë euro), BERZH (67.5 milionë USD ose 50 milionë euro), BEI (67.5 milionë USD ose 50 milionë euro), IDB (10 milionë USD), dhe ka avancuar në të gjithë komponentët e tij

NURI DRAGOJ

**N**ë vendin tonë ndodhin fenomene interesante. Pozita punon dhe tregon atë çfarë ka bërë, ndërsa opozita kundërshton ato realizime, duke ngritur në qiell "gogolin korrupsion".

Dhe donatorët e huaj me të drejtë mund të frenohen apo detyrohen të pyesin veten: A shkojnë me të vërtetë financimet tona në destinacion apo shpërdorohen, ashtu siç pretendon opozita? Dhe, në kushte të tilla, dërgojnë ekipe pas ekipe, për të verifikuar cilësinë e punimeve, duke shkelur metër për metër rrugët e ndërtaura e ato në ndërtim, për të parë me sytë e tyre çfarë bëhet me paratë e taksapaguesve të vendeve që sakrifikojnë financat e tyre për të rindërtuar Shqipërinë. Këtë e dinë shumë mirë dhe disa nga krerët socialistë, të cilët kanë filluar të kundërshtojnë njëri-tjetrin, duke e quajtur një turp bllokun e akuzave pa baza lidhur me korrupsionin. Dhe, sipas një prej anëtarëve të kryesisë së PS-së, "gogoli i korrupsionit" po bren nga brenda vet socialistët, të cilët nuk besojnë në radhë të parë kreun e tyre, Rama, i cili mund të jetë ndër mbi milionerët e këtij vendi.

Një shok më thotë një ditë: Ore po kjo politika jonë, kur do të ketë një gjuhë të përbashkët, të paktën kur është fjala për interesa kombëtare? Dhe një nga interesat madhore kombëtare është thithja e investimeve të huaja, për të pasur sa më shumë rrugë të mira, ku të kalohet lehtësisht me mjete, të ketë mundësi të rritet shkalla e qytetërimit edhe në zonat rurale; të kemi sa më shumë ujësjellës, pasi është e papranueshme që një vend si Shqipëria, me ujë ngado, qytetarët e vet të vuajnë për ujin e pijshëm, apo të mos kenë sasisitë e duhura në 24 orë; të kemi sa më shumë shkolla, që fëmijët tanë të ulen në banka komode dhe të kenë bazën e nevojshme materiale për të mësuar. E pastaj, tjetri shton: qeveria e Papandreut lëshoi alarmin për situatë kritike në ekonomi dhe opozita nuk tha asnjë fjalë se

nuk punon qeveria, apo ka korrupsion të madh, por u bashkua me qeverinë në kërkim të ndihmave financiare, derisa ia arritën qëllimit. Bashkëpunojnë,

pranon hapur se ka korrupsion. Zotërinj!, tha ai në një bisedë televizive. Në Shqipëri ka korrupsion. Dhe do të ketë, pasi nuk është aq e lehtë për t'u çr-

Harta punët në komunitet



sepse shohin interesat kombëtare. Pozita druhet të ngrejë dhe një shqetësim të vogël, se opozita hidhet përpjetë. Kryeministri Berisha, është i pari kryeministër në Shqipëri, që

rënjosur kjo e keqe e madhe. Por e rëndësishme është, që qeveria do të bëjë të pamundurën për ta minimizuar atë. E rëndësishme është që qeveria Berisha i ka shpallur luftë korrup-

Harta treguese e rugeve dytesore dhe lokale ne zbatim nga FSHZH per vitin 2010  
REPUBLIKA E SHQIPERISE



sionit, gjë që duket në çdo hap. Janë dhjetëra zyrtarë që kanë vizituar qelitet e burgut për shkak të korrupsionit. Pra, toleranca ndaj një shfaqjeje të tillë, ka qenë zero. A mund të na tregojnë të majtët, sikur edhe një rast të vetëm, kur të kenë arrestuar funksionarë e zyrtarë të lartë? Nuk mund të thotë asgjë, pasi nuk ka pasur asnjë rast të tillë. Mos vallë nuk ka pasur korrupsion në qeverisjen e tyre? Mos vallë, me të vërtetë, Edi Rama ka 2 mijë euro? Të besosh këtë është një marrëzi e madhe. Korrupsioni në kohën e qeverisjes socialiste ka qenë shumë i madh. Ndryshimi midis qeverisjes së majtë dhe asaj të koalicionit të djathtë, qëndron në faktin se të parët e lanë të lirë korrupsionin në rrugën e vet, ndërsa të dytët i kanë prishur qetësinë dhe ai nuk gjen vend ku të rrijë. Shumica e qeveritarëve të Partisë Socialiste janë bërë milionerë dhe kjo në sajë të korrupsionit që kanë bërë në kurriz të popullit shqiptar.

Qeveria bën të pamundurën që shqiptarët të lëvizin të lirë në Evropë. Opozita bën të pamundurën që të mos realizohet lëvizja e lirë. Pra, nuk bashkëpunon me qeverinë as në një problem kaq madhor për shqiptarët e lodhur nga varfëria dhe mbyllja në vendin e tyre për shkak se Perëndimi ka qenë zonë e ndaluar për ta. Është për t'u habitur, por kështu është. Qeveria rrit pensionet, ata thonë se qever-

ia po merr borxhe për të shlyer pagat e pensionet. Duan vetëm ta nxijnë realitetin, të ngjallin pakënaqësi, të mërzhisin qytetarët me vendin e tyre dhe të mos kenë shpresë, por të ardhmen ta shohin rrugëve të kurbetit. Sërish detyrohet Kryeministri t'u thotë shqiptarëve të qëndrojnë të qetë, pasi qeveria nuk ka marrë asnjë borxh për paga e pensione, madje ka zbritur me gati 20 për qind borxhin e trashëguar nga socialistët.

**MUNGESA E KORRUPSIONIT BËN QË TË SHUMËFISHOHEN FINANCI MET PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT**

Le të kthehemi edhe një herë te Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nuk po merremi fare me miliardat e financuara nga qeveria, për të treguar se donatorët e huaj, e dinë shumë mirë se ku shkojnë paratë e tyre. Jo sepse besojnë verbërisht te drejtuesit dhe ekipi i FSHZH-së, por, sepse kontrollojnë hap pas hapi ecurinë e fatit të parave që ata japin. Në rast se do të konstatojnë abuzime, nuk do të jepnin asnjë para. Po të ishte se do të kishte korrupsion gjigant e galopant, siç pretendojnë të majtët, financimet e donatorëve të huaj nuk do të kishin shënuar rritje me shumëfish por do të ishin kufizuar me shumëfish. Dhe, më konkretisht. Në shkrimin e djeshëm pohuam se vlera e parashikuar e programit 5-

vjeçar është 400 milionë USD. Deri më sot, qeveria shqiptare dhe FSHZH, kanë vënë në zbatim një fond prej 252 milionë USD. Për vitin 2010, janë firmosur marrëveshjet me BERZH, BEI, dhe IDB, dhe pritet të fillojë disbursimi i fondeve. Projekti deri në qershor 2010, është financuar nga Banka Botërore (20 milionë USD), OPEC Fund (15 milionë USD), qeveria shqiptare (5 milionë USD), CEB (56 milionë USD ose 40 milionë euro), programi IPA 2008 (11 milionë USD ose 8 milionë euro), BERZH (67.5 milionë USD ose 50 milionë euro), BEI (67.5 milionë USD ose 50 milionë Euro), IDB (10 milionë USD), dhe ka avancuar në të gjithë komponentët e tij. Besoj se kjo do të mjaftojë për të bindur gjithë skeptikët dhe të mbushi me shpresë për zhvillimin e këtij vendi gjithë ata që e presin këtë ndryshim me dëshirë e padurim.

Për zbatimin dhe konkretizimin në praktikë të këtyre financimeve ka një strategji të caktuar, ka një program me komponentë të përcaktuar qartë, të cilët janë si më poshtë:

**FINANCIMI I AKTIVITETEVE MBËSHTETËSE TË TË GJITHË PROGRAMIT**

Në administrimin e fondeve të donatorëve ka një kërkesë shumë të fortë dhe nuk lejohet të shkelet asnjë nga procedurat. Vijnë në faqen 15

**Vijon nga faqja 14**  
Ky komponent, që mund të emërtohet dhe "komponenti i parë", përfshin përgatitjen e fazës së të dhënave për rrugët rurale si dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimeve për fazën e implementimit. Përgatitja e këtij dokumentacioni është realizuar në bashkëpunim me konsulentin anglez, Roughton International. (RI)

Sipas specialistit të FSHZH-së, Ermal Iliriani, për krijimin e bazës së të dhënave, është krijuar një inventar i plotë me të dhëna të detajuara për rreth 3500 km, të identifikuar si rrugë kryesore të rrjetit rrugor rural. Këto segmente rrugore janë përzgjedhur nga çdo qark, në bazë të prioriteteve e të shpenzimeve aktuale të mirëmbajtjes. Janë mbledhur të dhëna të hollësishme për të gjithë seksionet rrugore (rreth 525 segmente) sipas popullsisë, varfëria në zonë, trafiku, gjendja e rrugës, aksesit kundrejt shërbimeve, tregjeve dhe qendrave administrative. Është bërë një analizë shumë kriteresh për secilin nga këto seksione e përbërë nga disa komponente. Analizimi shumë kriteresh dhe prioritizimi është bërë sipas standardeve të Bankës Botërore, me metodën REDS. (Road Economic Decision System). Janë hartuar projektet teknike për 400 km seksione rrugore, që janë në proces zbatimi ose të përfunduara.

Pjesë e metodologjisë së përdorur për inventarizimin, prioritizimin dhe funksionim mirëmbajtjen është ROMAPS, një soft i përdorur për herë të parë në Shqipëri në kuadër të këtij projekti.

Në datë gjashtëmajorit të parë të vitit 2010, ka filluar puna për përgatitjen e fazës së dytë të punës, që përfshin përgatitjen e çdo numrin e km të inventarizuara në 6200 km.

Pjesë e këtij komponenti është angjitja e kapaciteteve të njëjësive të qeverisjes vendore për të bërë një lidhje me funksionim mirëmbajtjen e rrugëve të reja. Përmes trajnimeve të organizuara nga stafi i FSHZH. Deri

-Të mirë, mo të mirë janë - ma ktheu ai, por shumë të bezdisshëm. Mbetën pas nesh, duke kërkuar dhe cingërima.  
-Ç'kupton ti me cingërima? - e pyes unë.  
-Vijnë dhe kontrollojnë në detaje, nuk të lenë të kalosh asnjë proces pa bërë, madhe dhe kur mund të mos jetë shumë i nevojshëm.


funduar për 8 rrugë në qarqet Fier, Tiranë, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, dhe Berat. Perspektiva e financimit Duke parë punët që janë kryer dhe përgjegjësinë që ndjen ekipi i FSHZH-së por dhe qeverisë, një nga financuesit e parë projektit, OFID ka vendosur të rifinancojë projektin me një shumë prej 10 milion USD. Mar-

nga Qeveria Shqiptare, Banka Botërore, dhe Banka e Këshillit të Evropës. E ndarë në tre lote (Kuben - Përroi i Kapsit; Përroi i Kapsit - Vleshë, Vleshë - Vasië), kjo rrugë përbën një nga arteriet kryesore të qarkut. Ndërrhyrjet në këtë rrugë kanë për qëllim zgjerimin e rrugës ekzistuese deri në një gjerësi prej 6,5 metrash, përfshi 4,5 m korsi të

Zerqanit me qytetin e Bulqizë. 6424 banorë ose 1280 familje përfitojnë në mënyrë të drejt-përdrejtë nga ky investim. Rikonstruksioni i rrugës do të sjellë impakt pozitiv për banorët përfitues duke lehtësuar aksesin kundrejt tregjeve rajonale dhe lokale, dhe do të lehtësojë cilësinë e shërbimeve. Elbasani përfshihet nga punët të shumta

Është në proces vijimi i punimeve për rikonstruksionin e rrugës "Belsh - Fierzë - Kosovë", financuar nga OFID (OPEC), dhe CEB, ku përfitojnë 12 komunitete ose 10,440 banorë. Vlera e investimit është 308 milionë lekë dhe rruga ka një gjatësi prej 16.4 km. Ka përfunduar faza e parë dhe punimet vazhdojnë normalisht. Është OFID, së bashku me mbështetjen e qeverisë shqiptare dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit që bënë të mundur implementimin e këtij projekti madhor për komunitat Belsh dhe Fierzë. Ky segment fillon në qytezën e Belshit, dhe përfshon një gjatësi 16.4 km deri në fshatin Kosovë të Komunës Fierzë, ku ndodhet dhe pika përfundimtare e fazës së dytë të këtij projekti.

Rehabilitimi përfshin zgjerimin e platformës ekzistuese dhe përforcimin e nënshtresave. Rruga ka një gjerësi 7 m, nga ku 5 m është gjerësia e karrexhatës së asfaltuar dhe 2 x 50 cm janë vendpushimet e automjeteve. Banorët pohojnë se gjendja shumë e keqe e rrugës përpara investimit, kishte vështirësuar ndjeshëm kushtet e transportit




-Përfshihen në projekt dhe kontratë ato apo janë kërkesa shtesë?  
-Përfshihen, përfshihen, por puna është se ne tenderët i fitojnë me vlerën më të ulët dhe është e vështirë të nxjerrësh pesë lekë fitim - tha tjetri.  
Për mua që bëra këtë bisedë, çdo gjë është e qartë. Le të shkojë ndonjë nga ata që besojnë përrallat politike dhe ka për të parë se puna që bëhet nga FSHZH është nga më cilësoret në vend. "Këta, - më thotë kryetari i Komunës së Velipojës, na turpëruan dhe ne me ndonjë punë që bëjmë, pasi cilësia ndryshon që në vështrim të parë.

Financimi i punimeve civile për përmirësimin e rrugëve prioritare rajonale apo lokale

rëveshja pritet të kalojë për ratifikim në Kuvendin e Shqipërisë. IPA 2010, 2011, do të financojnë 33 milionë Euro. FIBP, 4 milionë Euro Grant për mbështetjen teknike Qeveria Japoneze përmes Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar JICA, është duke negociuar me qeverinë shqiptare për të financuar me 70 - 100 milionë USD, në mbështetje të programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale. Për këtë është angazhuar prej disa muajsh një konsulent japonez, e cila ka shqyrtuar të gjithë elementet e programit, dhe në muajin Qershor 2010, është prezantuar raporti i detajuar për financimin e rreth 300 km rrugë dytësore dhe lokale. KfW, si një nga partneret kryesorë të qeverisë Shqiptare në projektet e implementuara nga FSHZH në vite, ka parashikuar të financojë 20 milionë Euro. Së bashku me financimin e 9 milionë Euro, nga IPA 2009, paketa e plotë prej 29 Milionë Euro do të përdoret për financimin e rrugëve dytësore dhe lokale (24 milionë Euro, dhe ndërtimin e ujësjellësve rurale në 3 Qarqet e Veriut,

shtruar me asfalt, 50 cm vendpushim dhe 50 cm bordurë në secilën anë.  
Nga ndërtimi i rrugës përfitojnë banorët e Komunave, Fushë Çidhën, Silovë dhe Kala e Dodës. 11 mijë banorë, ose 2600 familje përfitojnë në mënyrë të drejt-përdrejtë nga financimi i kësaj truge. Gjendja e rrugës përpara investimit ka qenë shumë e keqe, dhe e pakalueshme për një pjesë kohe të konsiderueshme në periudhën e dimrit. Rruga u shërben banorëve të zonës duke mundësuar lidhjen e tyre me qytetin e Peshkopisë. Ajo do të lidhet së shpejti edhe me qarkun e Kukësit, punimet e të cilit kanë filluar në kuadër të Programit "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale".  
Nëpërmjet këtij investimi të rëndësishëm, do të përgjysmohet koha e përshkrimit të rrugës, duke lehtësuar kështu shërbimin e transportit për komunitetet përfituese, dhe cilësinë e shërbimit. Njëkohësisht ky investim kontribuon në rritjen ndjeshëm të aksesit kundrejt shërbimeve dhe aktivitetëve ekonomike, tregjeve rajonale, dhe qendrave urbane, duke ndikuar në uljen e varfërisë dhe rritjen e zhvillimit social - ekonomik të komuniteteve përfituese.

Një tjetër projekt me rëndësi është rikonstruksioni i rrugës Ura e Qytetit - Zerqan, me vlerë financimi 121 milionë lekë, e cila është financuar nga Banka e Këshillit të Evropës. Rruga ka një gjatësi prej 6.3 km, dhe shtrihet nga Ura e Qytetit (Bulqizë) deri në fshatin Zerqan. Ajo shtrihet përgjithësisht në një terren kodrinor. Ndërrhyrjet në këtë rrugë kanë për qëllim zgjerimin e rrugës ekzistuese deri në një gjerësi prej 5 metrash, përfshi 3 m korsi të shtruar me asfalt, 50 cm vendpushim dhe 50 cm bordurë në secilën anë. Rikonstruksioni i kësaj rrugë do të ofrojë më shumë Komunën e



të njerëzve dhe mallrave, duke u bërë një pengese serioze për banorët e zonës. Zona nëpër të cilën kalon rruga lidh fushën e Elbasanit me fushën e Myzeqesë, Luginën e Devollit me atë të Shkumbinit. Rikonstruksioni i këtij segmenti rrugor shihet si mundësi për të ndihmuar zhvillimin e sektorit të bujqësisë, dhe agro-përpunimit, përmes rritjes së aksesit drejt tregjeve lokale dhe rajonale, zhvillimit të agro-biznesit, dhe sektorit të shërbimeve. Me të drejtë disa nga banorët që takuam, u shprehën shumë të gëzuar dhe uronin me zemër qeverinë për këto përpjekje serioze që bënë në përmirësimin e jetës së tyre. Me realizimin e këtij projekti përfitojnë drejtpërsëdrejti zhvillim ekonomik-social, përmirësim të kushteve të jetesës, afërsi me qendrat shëndetësore e arsimore, 10.440 banorë.

**RRUGË TË REJANË QARKUN TIRANË**

Ne po përmendim disa qarqe dhe në një moment tjetër mund të rendisim një mori projektesh

të porsapërfunduara apo në përfundim e sipër. Rikonstruksioni i rrugës Ura e Farkës - Qendër Fshat - Mustafa Koçaj, financuar nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare. CEB, për Komunën Baldushk, prej të cilit përfitojnë 14 komunitete, ose 6100 banorë. Vlera e investimit është 470,055,786 leke (4,947,955 USD) dhe rruga ka një gjatësi prej 15 km.

Ka përfunduar faza i financuar nga BB, në zbatim faza II financuar nga CEB. Projekti është mundësuar në sajë të bashkëpunimit midis Bankës Botërore së bashku me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare CEB, dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit, që bënë të mundur implementimin e tij për komunën e Baldushkut. Ky segment fillon që tek Ura e Farkës e përfshon një gjatësi 15 km deri Mustafa Koçaj, ku ndodhet dhe pika përfundimtare e fazës së dytë të këtij projekti. Rruga ka një gjerësi 7m dhe pjesë përbërëse e tij janë ndërtimi i mureve mbajtëse dhe kanalet anësore të alternuara të hapura dhe me beton. Vlera e këtij projekti është 470,055,786 lekë. Gjendja shumë e keqe e rrugës përpara investimit kishte vështirësuar jo vetëm kushtet e transportit të njerëzve dhe mallrave, duke u bërë një pengesë serioze për banorët e zonës. Me realizimin e këtij projekti përfitojnë drejtpërsëdrejti zhvillim ekonomik-social, përmirësim të kushteve të jetesës, afërsi me qendrat shëndetësore e arsimore 5267 banorë të 14 fshatrave të komunës Baldushk. Me përfundimin e këtij aksi rrugor modern, ulet ndjeshëm koha e transportit të banorëve për në qytetin e Tiranës dhe Elbasanit. Komuna Baldushk ndodhet vetëm 15 km larg Tiranës dhe kualifikohet në veri me Komunën Vaqarr, në jug me Komunën Përparim, nga lindja me Komunën Berzhite dhe Komunën Petrele dhe nga Perëndimi me Komunën Pezë dhe rrethin e Kavajës. Në vijim do të paraqesim dhe projekte të tjera, për të treguar edhe një herë me shifra dhe fakte, që me të vërtetë qeverisja Berisha ka në objektivi të saj ndryshimin e Shqipërisë, gjë e cila nuk është thjesht slogan elektoral, por një realitet i prekshëm që po gëzon kudo shqiptarët, pasi janë projekte të prekshme direkt prej tyre dhe që kanë dhënë efektet e para në përmirësimin e ekonomisë personale për secilin fermer të këtyre zonave. Madje, objektivi i qeverisë është që në fund të këtij mandati të saj, të kenë përfunduar shumica e rrugëve dhe në fund të mandatit tjetër, të mos ketë fshat pa rrugë të asfaltuar.



qershor 2010, janë trajnuar rreth 250 persona, pjesë e stafit të qarqeve, dhe NJQV-ve, në të gjithë vendin.  
Besoj, vetëm komponenti i parë do të mjaftonte për të treguar seriozitetin, me të cilin punohet në këtë projekt, por edhe përgjegjësinë që ndihet deri në zbatim të tyre. Duke folur me një firmë gjatë zbatimit të një projekti, për të cilin kishte fituar tenderin në FSHZH, kujtova kartë kërkesën e madhe në rrejtin të cilësisë.  
Kini fat, i them drejtuesit të firmës përkatëse, pasi personin në FSHZH e kini shumë të mirë.

Ky qubet ndryshe dhe komponenti i dytë. Në këtë komponent janë financuar 362 km rrugë dytësore dhe lokale deri në muajin qershor 2010. Me fondet e Bankës Botërore dhe OFID janë financuar 108.7 km, dhe me fondet e CEB po financohen 223 km akse rrugore në 12 qarqe të vendit. Ndërkohë, nga fondet e IPA 2008, janë financuar 30.5 km rrugë.  
Këto rrugë u përzgjedhën nëpërmjet një procesi pjesëmarrës dhe bazuar në kriteret objektive social-ekonomike dhe teknike, duke përfaqësuar akset kryesore rrugore të qarqeve. Aktualisht, punimet kanë përfunduar për 8 rrugë në qarqet Fier, Tiranë, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, dhe Berat. Perspektiva e financimit Duke parë punët që janë kryer dhe përgjegjësinë që ndjen ekipi i FSHZH-së por dhe qeverisë, një nga financuesit e parë projektit, OFID ka vendosur të rifinancojë projektin me një shumë prej 10 milion USD. Mar-

**CFARË NDRYSHIMESH SHOHIM NË QARKUN E DIBRËS**

Janë në zbatim një sërë projektesh, nga të cilët mund të përmendim: Rikonstruksion dhe ndërtim i rrugës Kuben - Vasië, me vlerë financimi 863 milionë lekë, me një gjatësi prej 34.3 km. FSHZH i ka të gjitha detajet rreth saj Rruga është financuar